



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19 Prill 2023

Nr: 391

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 150, TË QENDRES “QËNDRESA QYTETARE” NDAJ BASHKISË KONISPOL, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 19 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Qendra “Qëndresa Qytetare”

SUBJEKT: Z. Shuaip Beqiri, Kryetar i Bashkisë Konispol
Zj. Keida Kula, person përgjegjës për raportim, bashkia Konispol

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur denoncimi nëpërmjet shkresës datë 24.02.2023, administruar pranë nga ana jonë me nr. 1139 prot., datë 27.02.2023, me denoncues Qendra “Qëndresa Qytetare”. Pala denoncuese pretendon se ka patur përdorim të burimeve publike në mbështetje të Partisë Socialiste të Shqipërisë nga ana e kryetarit të bashkisë bashkisë, z. Shuaip Beqiri.

Data: 19 Prill 2023

Nr: 391
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të qendres “Qëndresa Qytetare”,
ndaj Bashkisë Konispol”

Në denoncimin me nr. **150 ID** të qendrës “Qëndresa Qytetare” pretendohet si më poshtë vijon:

“Bashkia Konispol, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur një denoncim nga qendra “Qëndresa Qytetare” nëpërmjet shkresës datë 24.02.2023, administruar pranë nesh me nr. 1139 prot., datë 27.02.2023 ku pretendohet se: “Më datë 9 Shkurt 2023, gjatë ditës, Ministri i Financave dhe Ekonomisë zj. Anila Denaj, së bashku me kryetarin e bashkisë z. Shuaip Beqiri kanë organizuar një takim në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Rait Bajo”, Shalës, Konispol. Postimi në rrjetin social “Facebook” është shoqëruar nga zj. Denaj me përshkrimin si vijon: “Shalës, Konispol - Vijuam me Kryetarin e Bashkia Konispol - Shuaip Beqiri takimet me banorët e zonës. Falë investimeve të relizuara është arritur të ketë përmirësime në zonë ndaj dhe problematikat mbeten të pakta. Objektivi ynë është të përmirësojmë ndërlidhjen, të rrisim bashkëpunimin me pushtetin vendor dhe t’ju jemi pranë banorëve për zgjidhjen e shqetësimeve të tyre. #TeBashkuarjoTëNdarë #SkaKohëPërPushim”.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Në vijim të procedurës administrative, fillova hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Denoncuesi pretendon se nëpërmjet kryerjes së aktivitetit të mësipërm është përdorur një burim publik në mbështetje të subjekteve zgjedhore, referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020.

Më datë 7.3.2023 bashkisë Konispol i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 10.3.2023, bashkia Konispol sqaron dhe bën me dije se “Aktiviteti nuk është organizuar nga bashkia Konispol, por nga Kryesia e fshatit Shalës në lidhje me disa kërkesa të banorëve. Pranë bashkisë me datë 7.2.2023, ka ardhur një ftesë nga kryetari i fshatit i cili kërkonte të zhvillonte një takim me kryetarin e bashkisë dhe zj. Denaj për të diskutuar disa probleme që lidhen me certifikimin ose regjistrimin e Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe

Data: 19 Prill 2023

Nr: 391
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të qendrës “Qëndresa Qytetare”,
ndaj Bashkisë Konispol”

zgjidhjen e problemit të furnizimit me energji elektrike. Në takim kanë qenë të pranishëm dhe drejtuesit e këtyre institucioneve pikërisht për këtë çështje. Pra bashkia Konispol nuk mbart detyrimin për të raportuar aktivitete të cilat nuk janë të organizuara prej saj. Përsa i përket faktit që takimi është zhvilluar në shkelje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor ju sqarojmë se shkolla e fshatit Shalës është një qendër komunitare dhe si e tillë jashtë orarit mësimor (takimi është zhvilluar në orën 14:00), ambientet e saj përdoren për aktivitete, që lidhen ngushtësisht me komunitetin dhe problemet që shqetësojnë ata. Aktiviteti i zhvilluar ka qenë një aktivitet pa asnjë lidhje me fushatën elektorale. Këto ambiente nuk janë vënë në dispozicion të asnjë kandidati, partie politike apo koalicioni por në funksion të banorëve pavarsisht bindjeve apo përkatësisë politike, të cilët kanë kërkuar takim me institucione vendore dhe qendrore që kanë kompetencat dhe detyrimin ligjor ti trajtojnë ato. Për sa më lart në asnjë moment bashkia Konispol nuk ka shkelur ligjin. Përdorimi apo keqinterpretimi i këtij takimi për interesa jashtë atyre që lidhen ngushtësisht me interesat e komunitetit nuk janë përgjegjësia jonë. Bashkëngjitur po ju vendosim dhe kërkesën e ardhur nga Kryetari fshatit Shalës.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 15.3.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur.

Të pranishëm në këtë seancë ishin përfaqësuesi i qendres “Qëndresa Qytetare” z. Rigels Xhemollari dhe përfaqësuesi i bashkisë Konispol, të cilët mbajtën qëndrimet e tyre dhe dhanë sqarime lidhur me këtë proces hetimor.

Në seancën publike, përfaqësuesi i qendrës “Qëndresa Qytetare”, z. Xhemollari parashtroi dhe mbështeti edhe një herë deklaratimet e bëra në denoncimin e depozituar dhe pretendon se në këtë rast ndodhemi në kushtet e keqpërdorimit të burimeve publike. Denoncuesi konstaton në deklaratimin e tij se shkolla është vënë në dispozicion të deputetit Znj. Denaj.

Në vijim të seancës publike, përfaqësuesi i bashkisë Konispol deklaroi ndër të tjera se aktiviteti në fjalë është thirrur nga komuniteti dhe nga kryesia e fshatit Shalës pjesë përbërëse e bashkisë Konispol, pjesëmarrësit në këtë aktivitet kanë qenë në lartësinë e funksionit që ata posedojnë, lidhur me problematikat e menjwhershme. Sipas përfaqësuesit të bashkisë njoftimi ka ardhur në bashkinë Konispol një ditë përpara për këtë takim. Në vijim përfaqësuesi ka deklaruar se godina në të cilën është zhvilluar aktiviteti, është një godinë publike e cila përdoret vazhdimisht për aktivitete të ngjashme dhe funksionin edhe si qendër komunitare në atë zonë dhe aktiviteti është zhvilluar në orën 14:00, pas përfundimit të procesit mësimor. Sipas tij një pjesë e kësaj godine funksionon si sallë ku bëhen edhe aktivitet të tilla.

Gjatë hetimit administrativ është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike edhe Zyrës Vendore Arsimore Sarandë-Konispol-Delvinë (në vijim referuar si ZVA) .

Në përgjigjen e saj, ZVA bën me dije se nuk kanë patur informacion mbi zhvillimin e aktivitetit si dhe përcjellë për njohje edhe informacionin nga shkolla 9-vjeçare “Rait Bajo” Shalës.

Shkolla 9-vjeçare “Rait Bajo”, Shalës, ka bërë të ditur në përgjigjen e saj se “...nuk është dhënë leje për zhvillimin e aktivitetit dhe se ky aktivitet është zhvilluar pasdite, pas mbarimit të procesit mësimor dhe në kohën kur, institucioni është në mirëmbajtje dhe në ruajtje nga ana e bashkisë.”

Nga verifikimi i të gjitha fakteve dhe provave lidhur me sa më sipër, pas verifikimit edhe të materialeve të marra nga denoncimi, por edhe të pretendimeve të palëve në seancë, rezultoi se:

Referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor “Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”, bashkia Konispol ka sqaruar se aktiviteti është kërkuar nga kryesia e fshatit. Kryesia e fshatit mbështet funksionet vetëqeverisëse të bashkisë në zonën ku është ngritur, mënyrën e përdorimit të burimeve të përbashkëta dhe në çdo kohë mund të kërkojë takime për zgjidhjen e problematikave të zonës.

Megjithatë, referuar pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, subjektet që kanë detyrimin për raportim në ndërfaqe janë të përcaktuara qartësisht. Kryesia e fshatit shërben si organ këshillimor pranë kryetarit të bashkisë dhe si ndërmjetës me komunitetin, megjithatë nuk futet të rrethin e subjekteve që ka detyrim për të raportuar. Pjesëmarrja e kryetarit të bashkisë Konispol në aktivitete me banorët e zonës, për zgjidhjen e problematikave shqetësuese, është në kuadër të përmbushjeve të detyrave funksionale.

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999, “Statusi i Deputetit”, deputeti gëzon një status të veçantë në marrëdhëniet juridike, që ka me gjithë organet qendrore dhe vendore në vend. Deputeti, si pjesë të detyrave funksionale ka edhe takimet periodike me zgjedhësit ose kur e kërkojnë ata.

Si përfaqësues i banorëve, ka detyrimin t’ju japë shpjegime për projektligje, amendamente, vendime, rezoluta apo deklarata që shqyrtohen dhe miratohen në Kuvend si dhe çdo lloj problematike. Pjesëmarrja e tij në çdo lloj aktiviteti, qoftë ky i organizuar nga banorët, kryesia, kryetari apo nivel më i lartë nuk e bën aktivitetin të ndaluar.

Referuar pretendimeve të bashkisë Konispol se shkolla 9-vjeçare “Rait Bajo”, Shalës shërben si qendër komunitare, e hapur ndaj komunitetit dhe që vihet në shërbim të plotë të tij, **pa cenuar procesin e mësimdhënies.**

Përdorimi i ambienteve të shkollës në takimin e banorëve të zonës, në diskutimin e problematikave nuk përbën veprimtari të ndaluar, **për atë kohë sa nuk provohet “qëllimin zgjedhor” apo mbështetja e një kandidati apo subjekti zgjedhor, nga vënia në dispozicion e tyre.**

Përdorimi i këtyre ambienteve, për qëllime të tjera “jo zgjedhore”, del jashtë kompetencës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për të vlerësuar, nëse këto ambiente lejohen apo jo, për t’u përdorur përçdo lloj aktiviteti.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit të materialeve u vlerësua se aktiviteti i zhvilluar nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenet 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 dhe 171/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ për z. Shuaip Beqiri, kryetar i bashkisë Konispol dhe moskonstatimin e shkeljes.
2. Pushimin e hetimit administrativ për zj Keida Kula, person përgjegjës për raportim dhe moskonstatimin e shkeljes.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 19 Prill 2023

Nr: 391
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të qendres “Qëndresa Qytetare”,
ndaj Bashkisë Konispol”